

Rregullat e pranimit në shkollë të mesme

ALBANSKA

utbildningsinfo.se

Skolverket

Çka kërkohet për t'u pranuar në shkollë të mesme profesionale

Për t'u pranuar në një shkollë të mesme profesionale kërkohet që ju:

- Të keni kryer klasën 9-të të shkollës fillore
- Dhe nuk e keni kryer arsimin e mesëm më parë
- Fillon shkollimin më së voni në gjysmën e parë të vitit kalenderik kur ju i mbushni 20 vjet.

Për t'u kualifikuar për një program profesional kërkohen nota kaluese në gjuhë suedeze apo suedishtja si gjuhë jo-amtare, gjuhë angleze dhe matematik si dhe nota kaluese në më së paku pesë lëndë tjera.

Për t'u kualifikuar për ndonjë program përgatitor të arsmiit të lartë kërkohen nota kaluese në gjuhë suedeze apo suedishtja si gjuhë jo-amtare, gjuhë angleze, matematik si dhe nota kaluese në më së paku nëntë lëndë tjera të shkollës fillore.

Për programet ekonomike dhe shoqërore si dhe programet humane, duhet që katër lëndë nga ato të nëntat të jenë: gjeografia, historia, dituri shoqërore dhe religjioni.

Për programin e shkencave natyrore dhe programet teknike, duhet që tri lëndë nga ato të nëntat të jenë: biologjia, fizika dhe kimia.

Për programet estetike vlejné notat kaluese nga cila do lëndë qoftë.

Për t'u kualifikuar për të ashtuquajturën variant të posaqëm mund të shtrohen kërkesa për paranjohuri në një lëndë të tillë apo fushë lënde që është karakteristike për atë variant.

Kështu e llogaritni vlerën t'uaj kualifikuese

Për programet e popullarizuara, shpesh ndodhë që numri i aplikantëve është më i madh se numri i vendeve të lira. Në ato raste, shkolla bënë një përzgjedhje. Ata që kanë vlerën më të lartë kualifikuese pranohen. Vlera kualifikuese është, shumta e vlerës së 16 lëndëve me notat më të mira. Për drejtime me provime pranuese, llogariten edhe pikët e provimit pranues.

Vlerat e notave për ju që keni kryer shkollën fillore më 2011 janë:

MVG = 20 VG = 15 G = 10

Vlerat e notave për ju që do t'a kryeni shkollën fillore prej 2012 – është tutje janë:

A = 20 B = 17,5 C = 15
D = 12,5 E = 10 F = 0 (d.m.th. jo-kaluese)

Vlera e notave për një bllokë lëndësh si p. sh. shkencat natyrore (fizikë, kimi dhe biologji), nxirret duke e përpjestuar vlerën e notës së bllokut të lëndëve me numrin e lëndëve brenda atij blloku. Nota maksimale apo siq quhet, vlera kualifikuese është 320 pikë.

Që nga pranimi për vitin shkollor 2014/15, ju që keni pasur ndonjë gjuhë bashkohore si përzgjedhje gjuhe, mund t'a llogaritni vlerën e notës së kësaj lënde, përveq atyre 16 notave më të mira. Vlera maksimale kualifikuese do të jetë pra 340 pikë.